



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 337/01
Datë: 29.06.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet **Instituti për aftësim profesional dhe përkrahje të punësimit "Dituria"** në Prizren me adresë Rruga: "Shaip Spahia" nr 47, për periudhën 02.06.2017 deri 02.06.2020 për të ofruar kualifikimin e validuar në KKK:
 - 1.1. Parukeri; Niveli III sipas KKK, me 24 kredi të AAP.
2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:
 - 2.1 Plotësimi i bazës materiale (literatures) mbështetëse për çdo kandidat në mënyrë individuale për çdo post pune.
 - 2.2 Hartim i politikave për zhvillim profesional të stafit mësimdhënës/trajnerëve në aspektin metodik dhe didaktik si dhe çertifikimi i tyre.
 - 2.3 Të vendoset kutia e sygjërimeve në ambientet e qendrës.
 - 2.4 Të vendoset brenda ambienteve të parukerisë kutia e ndihmes së parë.
 - 2.5 Të trajnohet dhe çertifikohet stafi për dhënien e ndihmes së parë dhe masat mbrojtëse kundër zjarrit.
 - 2.6 Të kompletohet qendra (instrukturë, kandidat) me uniforma pune me logon e qendrës.
 - 2.7 Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve të bëhet nga një ekip me anëtarë ku përfshihet edhe një vlerësues i jashtëm, ekspertë në profesionin e parukerisë që ushtrojnë profesionin e tyre.
 - 2.8 Qendra duhet të ketë një procedurë të shkruar të ankesave për kandidatë.

- 2.9 Të zhvillohet rregullore për lëshimin e çertifikatave duplikate në rast të humbjes së saj.
 - 2.10 Të përcaktohen: ditët e javës të vijimit të kandidatit, 5 ditë në javë me 4 orë mësimore në ditë.
 - 2.11 Përpilimi i një çertifikate ku përmbahen elemente të vlerësimit të kandidatit si në vijim:
 - 2.12 Vlerësimi të bëhet me pikë jo me notë
 - 2.13 Të paraqiten kompetenca të përfituara dhe vlerësimi përkatës.
 - 2.14 Paraqitja e orëve teorike dhe praktike për secilin modul në programin për Grim.
 - 2.15 Hartimi i një testi paraprak vlerësues i njohurive të kandidatit në fazën e hyrjes për regjistrim.
 - 2.16 Format i moduleve i paraqitur për 240 orë (24 kredi) të plotësohet të paktën deri në 320 orë që të jetë në përputhje me standardin e profesionit.
 - 2.17 Të vendoset në qendër kutia e ankesave dhe sygjerimeve në një hapësirë të përshtatshme.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën 31.10.2017, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
 - Dituria;
 - AKK.

Bedri Xhafa
Kryetari i KD së AKK-së

